



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 20 MARS 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 20. MARTA 2014. GODINE**

**MARS - MART
2014**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o transplantaciji tkiva i ćelija,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o osnivanju Agencije za usluge vazdušne navigacije,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni zakona o deklarisanju, poreklu i kontroli imovine visokih javnih zvaničnika i deklarisanje, poreklo i kontrolu poklona za sva službena lica,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o javnoj nabavci u Republici Kosovo,
8. Drugo razmatranje Nacrt zakona o Kosovskom institutu za javnu administraciju,
9. Drugo razmatranje Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o statusu i pravima palih boraca, invalida, veterana, pripadnika OVK, civilnih ratnih žrtava i njihovih porodica.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Qeverinë s'e paskemi këtu,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta. Replika nuk ka në këtë pikë të rendit të ditës.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Sot dua të ndaj me ju shqetësimin e dhjetëra punëtorëve të arsimit në komunën e Mitrovicës dhe të Lipjanit, të cilëve ndërrimi i pushteteve po u përkon me largimin nga vendet e punës.

Të gjithë jemi dëshmitarë të protestave të nxënësve dhe prindërve që kanë ndodhur në Mitrovicë me rastin e largimit të disa drejtorëve pa asnjë bazë dhe që të gjithë drejtorë profesionalë dhe të certifikuar për menaxhim në arsim, ndërsa janë pranuar drejtorë aktivistë të partive politike dhe militantë të partive politike pa bazë dhe pa asnjë kriter.

Unë do t'i përmend vetëm dy fakte, të cilat do ta dëshmojnë këtë që e them dhe ju mund t'i verifikoni në çdo kohë dhe kur ju të keni mundësi. Për shembull e kemi Xhevdet Zenelin, kryetarin e Nëndegës së AKR-së në Selac, dhe është Remzije Alidemaj, aktiviste e Lidhjes Demokratike të Kosovës, e cila e ka të mbaruar Shkollën e Lartë Pedagogjike, ndërsa është diplomuar pas emërimit drejtoreshë.

Që të dy këta janë vetëm dy nga shembujt e shumtë, të cilët kanë ndodhur në Mitrovicë, e të cilët janë pranuar si drejtorë, duke sfiduar drejtorët me përvojë dhe me baza profesionale.

Po ashtu, kemi edhe në Lipjan raste të shumta të mësimdhënësve, të cilëve u është konfirmuar se do t'u shkëputet kontrata e punës, vetëm pse ata dyshohen se janë votues të një partie, apo një partie tjetër.

Unë sot nga ky Kuvend kërkoj që të ndalet ky trend i ndëshkimit të qytetarëve mbi baza partiake. Jemi në demokraci dhe qytetarët duhet ta ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar, sepse ky trend i cili ka filluar të ndodhë në Kosovën tonë mund të na rrezikojë që në zgjedhjet e ardhshme të mos kemi votues të mjaftueshëm dhe të reflektojmë me

mosdaljen e qytetarëve në zgjedhje, sepse jam e bindur që qytetarët më lehtë do të zgjedhin që të rrinë nëpër shtëpi, sesa të dalin të votojnë për një parti apo parti tjetër dhe ta humbin vendin e punës, e t'i rrezikojnë familjet e tyre.

Prandaj, kërkoj që edhe në Mitrovicë, edhe në Lipjan, por edhe në komuna tjera, pavarësisht kush qeveris dhe kush është udhëheqës i atyre komunave, ta ndalojë këtë trend në ndëshkimin e qytetarëve mbi baza politike partiake. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot do ta ngre një çështje që ka të bëjë pikërisht me çështjen në fushën e mjedisit dhe që njëkohësisht ka të bëjë me degradimin e mjedisit, në përgjithësi. Do të thotë me ndotjen, meqë ende vazhdohet që në Kosovë si ndotësit më të mëdhenj të mjedisit dhe fushës së mjedisit janë termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, pastaj mihjet sipërfaqësore të linjtit në Obiliq, kompleksi industrial në Mitrovicë, “Ferronikeli” në Gllogoc, Fabrika e Përpunimit të Metalit në Janjevë, fabrika “Ballkani” në Suharekë, fabrika e çimentos “Sharrcem” në Han të Elezit, sistemi i ngrohjes Prishtinë, në Gjakovë dhe në Mitrovicë, e po ashtu edhe trafiku në përgjithësi.

Por, shqetësuese që unë sot do ta ngre, ka të bëjë një dukuri, e cila është shumë e evidente dhe kjo ka të bëjë me çështjen e gurthyesve. Në përgjithësi, në nivel vendi, e veçanërisht çështja e gurthyesve në komunën e Malishevës dhe po ashtu në fshatin Astrozub, ku deri më tani operojnë 7 gurthyes, për të cilët ende nuk dihet se a kanë leje për ta zhvilluar këtë veprimtari dhe sipas ligjeve në fuqi, të cilat i posedon Ministria e Ambientit, Komuna jep lejen e punës, Komisioni i Pavarur i Mineraleve jep licencën, ndërsa Ministria jep lejen mjedisore.

Nga vetë fakti që u bënë pothuaj se shtatë vjet e më shumë e në këtë fshat operojnë këta operatorë dhe kemi të bëjmë me një degradim total të ambientit në përgjithësi, por realisht është bërë e pamundur jeta e këtyre banorëve për shkak të detonimeve dhe të këtyre gurthyesve, me të cilët kanë filluar edhe të bëhet edhe çarja e shtëpive dhe po ashtu edhe degradimi i florës dhe i faunës në atë ambient.

Unë kërkoj në këtë rast nga institucioni përkatës, nga Ministria e Mjedisit dhe nga udhëheqja komunale e Kuvendit Komunal të Komunës së Malishevës, nga Inspektorati, të cilët në bazë të rregullores duhet të dalin në terren dhe të bëjnë verifikimin nëse këta operatorë i posedojnë këto leje dhe ta shohin gjendjen reale se si është degraduar ambienti, edhe në këtë fshat, por në përgjithësi edhe në nivel të vendit.

Prandaj, kërkoj nga Ministria e Mjedisit, nga udhëheqja komunale e Kuvendit Komunal të Malishevës që të merren masa urgjente në parandalimin e operatorëve, të cilët janë duke punuar në mënyrë ilegale. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Faton Topalli, në emër të Grupit.

FATON TOPALLI: I nderuar, kryetar!

Të nderuara kolege,

Të nderuar kolegë,

Që së shpejti do të kemi zgjedhje nacionale, këtë e dimë të gjithë, por kur do të mbahen këto zgjedhje e di vetëm kryeministri. Por, fushata paraelektorale e kryeministrit dëshmon se këto zgjedhje do të mbahen shumë shpejt.

Është e drejtë e secilit subjekt politik ta fillojë fushatën paraelektorale nëpërmjet plasimit të programit politik, por është abuzim dhe shkelje e ligjit, keqpërdorim i buxhetit dhe institucioneve të Kosovës për fushatat partiake, siç po ndodh me kryeministrin dhe Qeverinë e Kosovës.

Kryeministri i ngriti pagat për 25% për të gjitha kategoritë e shërbyesve publikë, për përfituesit e skemave dhe për pensionistët.

E para, kjo ngritje, edhe pse e madhe në përqindje, për shumicën e përfituesve është e vogël në përmbajtje. Edhe një rritje prej 100%, duke pasur parasysh nivelin e ulët të pagave të skemave sociale, nuk do të mjaftonte për ta siguruar një jetë me dinjitet për përfituesit e tyre.

E dyta, rritja e pagave nuk vjen si rrjedhim i zhvillimit ekonomik, sepse po të ishte kështu do të kishim ngritje të pagave edhe në sektorin privat, në të cilin rrogat janë minimale. Kjo ngritje nuk e stimulon krijimin e vendeve të reja të punës. Ajo rrit diferencën ndërmjet sektorit publik dhe privat dhe në vend se ta ulë, e shton edhe më shumë varfërinë.

Në mungesë të suksesit ekonomik, Qeveria u desh të shpikë instrumente për të lënë përshtypje në zhvillimit nëpërmjet ngritjes artificiale të pagave me vendim të Qeverisë. Rritja vjen dy muaj para zgjedhjeve dhe përbën vetëm një rritje momentale, sepse sipas kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2015 për paga dhe mëditje janë paraparë 520 milionë, ndërsa një vit më vonë, në vitin 2016 - vetëm 5 milionë më tepër.

Pra, shihet qartë se Qeveria gjatë projektimit të buxhetit nuk e ka paraparë ngritjen e rrugova si nevojë, por buxhetin po e shfrytëzon si mjet elektoral.

Prej vitit 2008, prej se kryeministri e ka marrë drejtimin e vendit e deri para pak ditësh nuk arriti të sigurojë nënshkrimin e një kontrate kolektive, e cila është kërkuar nga të gjitha anët.

Nuk arriti të bëjë një projektligj për veteranët e luftës. Nuk bëri asgjë për ujin në Prishtinë. Nuk arriti ta kthejë FSK-në në ushtri. Nuk e ekzekutoi vendimin e punonjësve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj.

Dhe, tani ato që kryeministri i tematizoi për 7 vjet me radhë arriti t'i fusë në agjendë brenda 30 ditësh. Nëse kjo nuk është fushatë elektorale, 'unë jam Hashim Thaçi'.

Pra, as kjo nuk është fushatë, a?! Domethënë, është fushatë. Kryeministri po fluturon me suksese dhe premtime elektorale. Por, 7 vjet gjumë të kryeministrit e një muaj shpend janë pak për t'u mbajtur mend si kryeministër i mirë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të ju them të drejtën, kur e kam lexuar për herë të parë kam qenë edhe vetë skeptike që në Kosovë, madje edhe në Qeverinë Thaçi mund të ketë njeri, për më tepër mund të ketë një nënë që është në gjendje të korruptohet deri në shkallën e rrezikimit të shëndetit publik nëpërmjet helmimit të fëmijëve me lëndë djegëse të kontrabanduar në Kosovë.

Po dua të theksoj që kjo çështje ka filluar në vitin 2008, domethënë gjashtë vjet më parë. Ju kujtohet të gjithëve kur Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka bërë një pyetje: Ku është vaji disulfurik, i cili po vazhdon edhe sot të kontrabandohet në Kosovë? Prej atëherë ne nuk kemi marrë përgjigje dhe prej atëherë Qeveria Thaçi nuk ka dhënë përgjigje se ku është ai vaj, kah po hyn dhe kah po shkon? Por, si duket përgjigjja është marrë ditëve të fundit, kur mostrat e disa ditëve më parë i kanë konfirmuar këto dyshime, do të thotë mostrat e dërguara në laborator në Itali kanë rezultuar të jenë vaj për djegie, e jo naftë derivati i përdorur, po e theksoj, për ngrohe të shkollave, çmimi i së cilit është për 30% më i lirë sesa çmimi i naftës.

Atje është konfirmuar se nuk bëhet fjalë për naftë, por bëhet fjalë për vaj për djegie me sasi të sulfurit 890 PPM, ndërsa kufiri ligjor në Kosovë dhe Bashkimin Evropian është 10 PPM dhe ashtu, siç thashë edhe dje, kjo, përveç që përbën një krim ekonomik, në një vend ku kanceri sidomos te fëmijët dhe moshat e reja është bërë dukuri, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka dëshirë për organet e hetuesisë, por mbi të gjitha edhe për Qeverinë Thaçi, t'i ngrejë disa pyetje, sepse ligji nuk zbatohet vetëm një herë në katër vjet gjatë fushatave zgjedhore, por ligji duhet të zbatohet për çdo ditë, e ne në vitin 2008 kemi pyetur se çfarë po ndodh me këtë vaj, i cili po shihet së fundi që shfrytëzuar për ngrohjen e shkollave tona.

Prandaj, disa nga pyetjet që i referohen edhe Qeverisë, por edhe organeve të hetuesisë, janë këto: Pasi asnjë kompani në Kosovë nuk është e licencuar për importin e vajrave gazore, kah ka hyrë ky derivat? Kah është kontrabanduar dhe cilat janë qëllimet, sepse po shihet që, përveç një krimi ekonomik, përbën kërcënim dhe papërgjegjësi ndaj jetës së fëmijëve tanë.

Nën dy, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka konfirmuar vetë se vajrat gazore për ngrohje nuk janë të licencuara për import dhe ky është mashtrim ekonomik, sepse çmimi i këtij vaji është diku 30% më i lirë sesa çmimi i naftës.

Nën 3, këtu e kam një dokument që është padi nga Naftëtarët e Kosovës, e ngrehur ndaj Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht ish-ministres Mimoza Kusari-Lila dhe zëvendësit të saj, tani ministër Bernardi. Kush po e ngulfat procedimin e kësaj lënde dhe

kush po e mbron këtë rast? Kjo është pyetja kyçe për organet e hetuesisë dhe për Gjyqësorin. Pse po ngulfatet në vazhdimësi? Këto janë me qindra-mijëra faqe dëshmi, të cilat u konfirmuan edhe dy-tri ditë më parë, por prapë nuk po shohim se hetuesia ose organet, ose Gjyqësori po vazhdon t'u japë përgjigje këtyre pyetjeve se, siç duket, dikush po e mbron dikëd, prandaj sot po e bëj pyetjen në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës: Kush po e mbron këtë rast dhe pse nuk po marrim përgjigje tash e 6 vjet?

Krejt për fund, ai aspekti moral, i cili po shihet që mungon shumë në këtë vend dhe sidomos në Qeverinë Thaçi, shtrohet pyetja: Për çfarë çmimi një qeveri i helmon fëmijët e vet? Ndoshta, nëse vijnë, do të na japin përgjigje. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, jo! Veç po ju njoftoj se kjo pikë është për deklarime jashtë rendit të ditës. Për çështjet tjera, mendoj që ka edhe mocion. Ministri mund të vijë dhe grupet mund të bëjnë kërkesë për mocion. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedniče!

Poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani,

U nekoliko navrata, tokom četvorogodišnjeg našeg mandata, zahtevala sam od Vlade, od predstavnika lokalne vlasti, odnosno pre svega od Ministarstva za lokalnu samoupravu proces lokalne samouprave, ili decentralizacije, da se odrazi podjednako za sve etničke zajednice.

Ono što smo imali za cilj kao Bošnjačka zajednica u Prizrenskom regionu, a uz to smo i uslovno podržali na lokalnim izborima Demokratsku partiju Kosova bio je proces decentralizacije, odnosno dobijanje opštine opštine u Župi, odnosno Rečane. Ono što je u ovom trenutku jako bitno jeste da smo i u pisanoj i usmenoj formi u nekoliko navrata tražili, jer ta teritorija ispunjava adekvatne uslove i kriterijume lokalne samouprave da dobije jednu normalnu opštinu koja bi funkcionisala kao i sve druge opštine. Ono što je u ovom trenutku jako važno jeste da većinsko bošnjačko stanovništvo, koje u tom kraju živi, taj proces je od prioritetne važnosti, zato što bi se u ovom trenutku zaustavio proces migracije tog stanovništva koja je jako na visokom nivou poslednjih nekoliko meseci.

Zatim bi se zaustavila problematika koja se dešava na Prevalcu, i suzbilo bi se ono što meštani Gornjeg Sela faktički imaju svakodnevnih problema, ali ono što je u ovom trenutku najbitnije jeste da podizanje socio-ekonomskog statusa našeg stanovništva dovelo bi do poboljšanja osnovnih uslova života tih građana.

Uz to, želim da napomenem da Ministarstvo za poljoprivredu jako malo ulaže u stočarstvo koje je najrazvijenija u tom kraju naše države i trenutni fond, odnosno grantovi koji se daju u ovom momentu su neprihvatljivi, odnosno ta aplikacija je jako konfuzna za meštane tog kraja.

Mi ćemo se još jednom obratiti Vladi Kosova da u što skorijem vremenskom periodu naš zahtev u pismenoj formi dođe na Vladi, kako bi smo ga mi ovde u parlamentu usvojili. Zahvaljujem!

KRYETARI: Deputetja Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Se gjendja e fëmijëve në Kosovë është e rëndë dhe se sëmundjet e ndryshme kanë prekur edhe një pjesë të fëmijëve, kjo është evidente dhe për këtë e përshëndes vendimin e kryeministrit që fondi i pagave të zyrtarëve të lartë në vlerë 5,5 milionë euro të përcaktohet si fond për shërimin e fëmijëve të sëmurë nga leukimia dhe kanceri.

Është shumë pozitive që përfitues janë fëmijët që kanë nevojë, meqë kjo është kategoria më e rrezikuar e fëmijëve të cilët kërkojnë kosto të lartë të shërimit. Në gjithë Kosovën janë gjithsej 200 fëmijë që vuajnë nga kanceri i gjakut, e në Klinikën e Pediatrisë janë 8 fëmijë, të cilët po trajtohen. Se trajtimi i këtyre realeve nga shteti është jo vetëm i nevojshëm, por edhe i domosdoshëm, tregon fakti se vetëm gjatë vitit 2013 numri i fëmijëve të prekur nga sëmundja e kancerit është 47, kurse 18 prej këtyre rasteve janë me leukemi.

Prandaj, vdekshmëria e këtyre fëmijëve është shumë e lartë dhe nëpërmjet këtij fondi të ndarë nga kryeministri i Republikës së Kosovës shpresoj që trajtimi i këtyre rasteve do të jetë më i lehtë dhe vdekshmëria e tyre të jetë më e ulët.

Njëkohësisht, dua të bëj edhe një falënderim për deputetët, të cilët me vendimin e tyre për t'i refuzuar pagat kanë mundësuar që këto mjete të shkojnë për këta fëmijë dhe për këto kategori. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar, unë në fakt kam ardhur këtu nga të parët, dhjetë minuta para se të fillojë seanca dhe ju sot prapë nuk e drejtuat seancën me korrektësi. Unë e kam kërkuar fjalën nga të parat.

Vërejtja ime nuk lidhet vetëm me seancën e sotme, por sidomos me të djeshmen, kur është bërë shkelja e Rregullores, sepse është ndaluar debati gjatë pikës kur u diskutua për Fabrikën e Gypave në Ferizaj.

Dua t'ju kujtoj të gjithëve ju dhe deputetëve se Kuvendi është kuorumi më i lartë i vendit. Përfaqësuesit e popullit këtu duhet ta japin mendimin e tyre. Këtu duhet të përplasen idetë, konceptet, në mënyrë që kur të vijë te vendimmarrja të jetë shoshitur gjithçka dhe të merret vendimi më i drejtë.

Kryetari i Kuvendit, kryetarët e komisioneve dhe kryetarët e grupeve parlamentare janë marrëveshje konvencionale për t'i respektuar procedurat, por ne të gjithë deputetët jemi të barabartë dhe jemi të gjithë të zgjedhurit e popullit. Të mos harrojmë që 95% e deputetëve të Kuvendit të Kosovës komunikimin kryesor me zgjedhësit e tyre e kanë

pikërisht nëpërmjet Kuvendit, e kjo është arsyeja se pse edhe transmetohet seanca dhe askush nuk ka të drejtë ta monopolizojë fjalën në Kuvend, apo foltoren e Kuvendit.

Prandaj, zoti kryetar, ju lus ta respektoni Rregulloren!

Çështja që desha të ngre unë sot, përveç kësaj të shkeljes së Rregullores, lidhet me memorialin “Heroinat”, një projekt i cili është drejt përfundimit, por që Komuna e Prishtinës ende nuk e ka marrë vendimin përfundimtar në lidhje me ndarjen e hapësirës se ku do të vendoset ky memorial. Prandaj, e shfrytëzoj foltoren e Kuvendit për t’i bërë thirrje Komunës së Prishtinës, kryetarit dhe Asamblesë komunale, që ta marrë vendimin përfundimtar në lidhje me ndarjen e kësaj hapësire, sepse në ndërkohë që puna po përfundon, puna e memorialit është shumë e rëndësishme të dihet edhe vendi, të cilin e kemi kërkuar. E ka kërkuar Ministria e Ambientit. Është ai prapa “Grandit”, një vend dinjitoz, ku do të vendoset i vetmi memorial për gratë, për kontributin e tyre gjatë luftës.

Tani, për çështjen që e ngriti kolegja ime Donika në lidhje me naftën, kam dëshirë t’ia shtoj edhe një pyetje. Nga informacionet që kam unë, e di që nafta, e cila kapet nga kontrabanda që vjen nga veriu, krejtësisht e pakontrolluar, askush nuk e dinë cilësinë e saj, depozitohet në HIB në saje të një marrëveshjeje që e ka bërë Ministria e Financave apo Doganat. Prandaj, unë kam pyetjen për ministrin e Financave se mbi çfarë kriteresh është bërë kjo marrëveshje me këtë kompani. Faleminderit!

KRYTEARI: Të gjithë deputetët që duan ta kritikojnë kryetarin për Rregullore, duhet të jenë njohës të mirë të saj dhe le ta lexojnë atë në tërësi. Neni 50, në mocionet procedurale, pika 5 shkruan: Mocioni për ta mbyllur debatin shqyrtohet vetëm nga kryetarët e grupeve parlamentare dhe votohet menjëherë dhe, që ta dini, në seancë unë e interpretoj Rregulloren, e jo deputetët. Përsëri lexojeni Rregulloren, e kur ta mësoni mirë atë, dilni në foltore. Foltorja e Kuvendit nuk është gazetari! Edhe këtë ta keni parasysh! Është pak edhe odë burrash dhe ka të bëjë me edukatën e secilit individ që është në sallë. Fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Tema të cilën do ta ngre sot është ulja e vazhdueshme e natalitetit në Kosovë. Pavarësisht faktit se vendi ynë e ka popullsinë më të re në rajon, ku përafërsisht rreth 70% e trungut demografik janë mbi moshën 30-vjeçare, rënia e vazhdueshme e natalitetit duhet të jetë një shqetësim serioz i institucioneve tona vendore, shqetësim të cilin asnjëherë nuk e ka pasur kjo Qeveri.

Të gjithë jemi në dijeni se nataliteti në Kosovë ka shënuar rënie shqetësuese në vitet e fundit dhe, sipas ekspertëve vendorë, nëse krahasohet me vende evropiane, sot Kosova e ka përqindjen më të lartë të rënies të natalitetit, përderisa në vendet tjera ekzistojnë faktorë stimulues, në Kosovë është një presion, ndoshta jo i vetëdijshëm, i cili në fakt është edhe diskriminues. Pra, politikat qeveritare deri më sot lirisht mund të themi se kanë dështuar në këtë drejtim.

Trendi i rënies drastike që tashmë është bërë dukuri duhet që në radhë të parë t'i shqetësojë institucionet dhe faktorët relevantë, të cilët kujdesen për shëndetin e nënës dhe të fëmijës në Kosovë.

Dihet se në rënien e natalitetit në Kosovë janë duke ndikuar shumë faktorë. Mendoj se një nga ta është edhe Ligji për lehoninë, i cili lehonave u jep vetëm 12 javë pushim, ndërsa gjendja bëhet akoma më e rëndë kur kemi parasysh edhe pohimet e zyrtarëve relevantë se kjo gjendje do të vazhdojë edhe më tej, për shkak të pamundësisë për t'i paguar lehonat gjatë këtij pushimi.

Të papranueshme janë edhe deklaratimet e vazhdueshme të institucioneve përgjegjëse vendore se këto janë pasoja të rrethanave ekonomike, ku shteti e as sektori privat nuk kanë mundësi financiare ta kompensojnë më gjatë këtë pushim.

Sa për krahasim, sipas të dhënave statistikore, brenda viteve 2000-2012 në Kosovë janë shënuar rreth 5 mijë lindje më pak. Përderisa në vitin 2000 kanë qenë të raportuara 40 000 lindje, në vitin 2012 numri ka rënë në 35 000.

Nëse merret për bazë shtimi i popullsisë së viteve të shekullit të kaluar, shihet se rënia e natalitetit në Kosovë është shumë e theksuar. Gjatë viteve të '90-ta nataliteti sillej rreth 30 promilë, ndërsa tash është përgjysmuar.

Duhet ta përmend një rast timin. Unë si nënë, në vitin 1994 kam lindur fëmijën e dytë. Si mësimdhënëse e kam pasur një vit pushim dhe pas defektit që fëmija im ka pasur në zemër, me rekomandimin e mjekut e kam marrë edhe një vit pushim dhe 100% jam paguar për 2 vjet. A do të thotë kjo që ne të kthehemi pas?

Ndërsa sot nënat e reja, fatkeqësisht, të punësuarat mendojnë si ta mbajnë vendin e punës dhe ndodh shpeshherë që edhe dështojnë pa dashjen e tyre për ta mbajtur familjen. Pra, mundohen që planifikimi i tyre të jetë një fëmijë, të mos them dy maksimumi.

Nëse ky trend do të vazhdojë në këtë ritëm, pa dyshim se do të vijë koha kur edhe ne do të fillojmë të kërcënohemi nga...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shqetësimi im ka të bëjë me rastet e fundit, rastin e fundit, konkretisht që është përfolur mjaftë, kohët e fundit, ditët e fundit, por edhe në media e që ka të bëjë me arrestimin e profesionistëve shëndetësorë, konkretisht mjekut Shpend Elezaj, i cili është një rast mjaft i rëndë sa i përket arrestimit të tij, ngase nuk është hera e parë që mantelbardhët, konkretisht profesionistët shëndetësorë arrestohen në mënyra të tilla.

Dhe, ajo çka është kryesore është se akt apo argument kryesor për arrestimin e një mjekut, qoftë për punën profesionale të tij është edhe raporti i Institutit të Mjekësisë Ligjore, e ne e dimë që akuzat e cila ka qenë edhe shkak edhe arrestimi i tij ka të bëjë me neglizhencën e rastit të pacientit nga i cili më pas ka pësuar dhe vdekja, por raporti i Institutit të Mjekësisë Ligjore e ka dhënë të kundërtën që shkaktar kryesor për vdekjen e pacientit e cilëson embolinë yndyrore mushkërore, çka nuk korrespondon me aktin e kryer nga ana e mjekut, do të thotë, pacienti është trajtuar për një trajtim kardiologjik, konkretisht për një koronarografi, ndërsa shkaktari i vdekjes ka qenë shkaktari nga embolia në mushkëri.

Prandaj, unë mendoj që arrestimet e tilla të ngutshme dhe jo njerëzore, jo etike përballë mantel bardhit duhet të ndalohen njëherë e përgjithmonë se nuk është hera e parë që arrestohen në mënyrë të tillë mantelbardhët.

Ne të gjithë e dimë, ka edhe raste kur shkelen edhe keqpërdoret detyra zyrtare nga mantelbardhët, por rastet e tilla apo gabimet e tilla profesionale duhet së pari t'i merret një raport Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe më pas të veprojë hetuesia dhe Policia e Kosovës.

Unë në këtë rast kërkoj nga edhe ministri i Drejtësisë edhe nga ministri i Punëve të Brendshme që ngrenë qendra të trajnimit, qoftë për prokurorë, qoftë për hetues policor që rastet e tilla së pari të identifikohen, të konstatohen dhe më pas të arrestohen se jo fillimisht arrestimi dhe më pas pason shfajësimi nëse ndodh si shumë ka ndodh me mantelbardhët.

Edhe unë në këtë rast jam optimist, edhe mjeku në fjalë i cili është një profesionist, një mësuesdhënës i shquar i Fakultetit të Mjekësisë, jam optimist se do të dalë i pafajshëm, por unë pyes veten dhe juve ku po mbetet kredibiliteti i mjekut, ku po mbetet autoriteti i tij dhe karriera e tij pas tërë kësaj çka po ndodh.

Po edhe njëherë i bëj thirrje edhe ministrit të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme që këtë çështje ta marrin më seriozisht dhe të ndalen këto arrestime, jo të drejta, jo njerëzore përballë mantelbardhëve. Faleminderit!

KRYETARI: I fundit për sot deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Duke e falënderuar Gëzimin që e shtroi një çështje që ka të bëjë me shumë tashmë me drejtësinë, por është fjala edhe për një prej mjekëve më të mirë, doktorëve më të mirë të përgatitur edhe në nivel vendor edhe ndërkombëtar.

Është mirë të trajtohen edhe këto çështje që i shtroi Gëzimi.

Unë pata që disa herë ta marrë fjalën, e ku nuk arrita në radhë këto javët e fundit, dy euro-deputetet Tanja Fajon edhe Ulrike Lunaçek kanë bërë një ftesë të euro deputetëve tjerë

dhe të institucioneve tjera të BE-së për përfshirjen e Kosovës brenda këtij viti në liberalizim të vizave.

Mendoj që është mirë që Kuvendi ynë zoti kryetar të gjejë ndonjë mundësi të bëjë një deklaratë edhe mbështetje për të gjithë euro- deputetët që po na mbështesin në këto procese kaq të rëndësishëm për ne, por edhe inkurajuese duke u bazuar edhe në informacionet që janë mjaftë pozitive kohëve të fundit për sa i përket Kuvendit dhe përmbushjes së detyrave nga Kuvendi për sa u përket detyrimeve që dalin në procesin e liberalizimit të vizave.

Edhe një çështje tjetër që ka të bëjë me Mbretërinë e Bashkuar, Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar, bashkë me ambasadën e tyre dhe Këshillin Britanik që po e ndihmojnë dhe me Ministrinë për Punë të Jashtme, institucionet e Kosovës në thellimin e bashkëpunimit me vendet, pesë vendet e BE-së që nuk na kanë njohur, vitin e kaluar janë realizuar një varg aktivitete duke përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës, vizitën në Sllovaki, këtë vit në Rumani, Këshilli Britanik në bashkëpunim po ashtu me Ministrinë e Jashtme dhe institucionet tjera po e mbështesin edhe biznesin edhe shoqërinë civile, edhe institucionet tjera në bashkëpunim të ndryshëm edhe me shtetin e Greqisë me shtetet: Rumaninë, Sllovakinë që i përmenda edhe shtetet tjera, vendet tjera që nuk na kanë njohur.

Është mirë në përfshirje sa më e gjerë e institucioneve tona në këto aktivitete.

Më lejoni, po ashtu meqenëse si kryetar i Komisionit, kolegja ime e shtroi këtu, pati edhe një dosje të sqaroj se kjo dosje nuk është e naftëtarëve, është e një kompanie e cila ka qenë e ngarkuar nga ana e Ministrisë për kontrollin e cilësisë së naftës e cila nuk është më.

Mendoj që këtu nuk duhet të ngatërrohen çështjet edhe kjo dosje tashmë, përveç që është e disa deputetëve është edhe në prokurori edhe në organet e drejtësisë.

Mendoj që këtu duhet që aktivitet tona, shqetësimet tona t'i trajtojmë në komision, partia e zonjës Kadaj, ka përfaqësues në komisionin tonë kur i kemi shqyrtuar më hollësisht këto çështje është mirë të mos shfrytëzohen derisa drejtësia të mos e thotë fjalën e vet të fundit, e po ashtu të mos bëhemi që shqetësimet tona tejkalojmë përtej këtyre që janë reale dhe të shkojnë edhe për shkak...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Faleminderit! Pasi po ankoheni shumë në këtë pikë të rendit të ditës, unë dua t'ju njoftoj se realisht kjo pikë e rendit të ditës nuk është për të dhënë lajme, do të thotë e para.

E dyta, është për të ngritur shqetësime që janë në interes të publikut dhe që s'mund të hynë në rend të ditës, dhe e treta që po ankoheni shumë për rendin e fjalës, unë po ju njoftoj që më mirë do të duhej të ishit ju grupet parlamentare, t'i caktoni nga dy më së

shumti tre deputetë të cilët do ta marrin fjalën në këtë pikë të rendit të ditës dhe kështu do ta menaxhonim më lehtë dhe ju nuk do të ankoheni.

E unë tash po ju them, që ka ndonjë rast që doni shëf i grupit të thotë që deputetëve të mi mos ua jep fjalën, por kjo është çështje tjetër. Kjo është çështje tjetër, unë po dua tu them që merrni vesh si grupe për këtë pikë të rendit të ditës që zgjat vetëm 30 minuta nga 2 veta apo 3 të lajmëroheni dhe unë e kam më lehtë ta menaxhoj seancën.

Por, nëse lajmërohen 10 deputetë të një grupi atëherë është e qartë që mbi 2-3 s'mund ta marrin fjalën. Ta keni parasysh që 30 minuta janë, nuk janë 3 orë këtu kjo pikë e rendit të ditës.

Kështu që ankesat e juaja po ju them që janë të pabaza, megjithatë ju keni të drejtë të ankoheni.

E kemi pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Nejse secili individ përgjigjet për nivelin e vetë të edukatës dhe të kulturës unë se kam mendjen të merrem me edukimin e askujt.

Kemi vetëm një ministër, pyetjet janë të ministrave që kanë pyetje asnjë nuk është këtu, nëse jeni dakord ne e shkurtojmë kohën sot për të bërë pyetje dhe kalojmë në pikat tjera të rendit të ditës.

Unë e kam për kohën e juaj se ju kah fundi po ikni tanë, por s'është problem për mua.

Deputeti Xhavit Uka pyetje për ministrin Dardan Gashi, ai e ka marrë përgjigjen me shkrim. S'ka nevojë.

Time Kadrijaj pyetje për ministrin Ferid Agani. Time, do ta bësh pyetjen? Urdhëro!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ka qenë për ministrin se pse është anuluar konkursi për drejtorë të klinikave të Qendrës Klinike Universitare dhe kur po mendon me e rishpallë sërish?

Mirëpo, ministri as seancën e kaluar s'ka qenë e as sot dhe është absurde pse nuk iu ka përgjigj thirrjeve për pyetje parlamentare dhe është çudi një ministër për një mandat të plotë, plotë 4 vjet prej vitit 2010 nuk ka mundur t'i zgjedh drejtorët e klinikave të Qendrës Klinike Universitare.

KRYETARI: Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani.

TIME KADRIJAJ: Është një vijë buxhetore për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore dhe një prej këtyre janë rastet ortopedike.

Ministri i ka ndal këto raste dhe është formuar një komision ku këto raste do të trajtohen në Kosovë, kjo ka qenë iniciativë e mirë. mirëpo, që një vit është shpall tenderi, tenderin për endoproteza e ka fituar një firmë që ka qenë më e shtrenjtë se sa firmat e tjera dhe tash në furnizimin e fundit kjo firmë përpos endoprotezave mjetet, të cilat i vendosin këto ortoproteza i ka pru të vjetra.

A ka qenë në kushte të tenderit për këto, a ka qenë që gjërat të cilat mjekohen pacientët e Kosovës të blihen në “otpad” dhe të sillen në Qendrën Klinike Universitare.

KRYETARI: Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj, pyetje për ministrin Agani.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,

Si duket zoti Agani edhe pse ka qenë gjithmonë i rregullt kohëve të fundit, në fund të mandatit nuk po ka vullnet sepse ka jashtëzakonisht punë për të kryer dhe që i kanë mbet peng i këtij mandati.

Unë iu kisha drejtuar ministrit me pyetjen: sepse ka shumë fëmijë që kanë probleme me të dëgjuar, kanë bërë implantin kohlear nga donatorët arab falas në vitin 2012.

Pas këtij operacioni këta fëmijë duhet të marrin ushtrime logopedike nga ana e logopedëve në kuadër të QKUK-së. Unë dua ta pyes ministrin se pse këto ushtrime nuk kryhen për pacientët e këtij lloji nga ana e logopedit në kuadër të QKUK-së, por pacientët detyrohen që këto shërbime t’i marrin në institucionet private duke paguar së paku 300 euro në muaj kur dihet se këto shërbime mund t’i marrin falas në QKUK.

Pra, deri më tani për këta fëmijë asnjë masë nuk është marrë nga ana e ministrit dhe ka pasur jashtëzakonisht shumë ankesa sa i përket këtij trajtimi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!
Pavarësisht se s’është ministri këtu unë sërish do ta bëjë pyetjen, e kam shtruar këtë pyetje edhe radhën e kaluar dhe dua ta theksoj këtu që kjo Qeveri është absolutisht e papërgjegjshme dhe nuk i interesojnë çështjet që ngrihen këtu nga deputetët dhe nuk i intereson se çfarë bëhet me qytetarët e Kosovës, po t’i interesonte do të ishte këtu.

I intereson vetëm për ardhur dhe për të bërë fushatë siç erdhi dje kryeministri me ministrin, të cilit unë ia drejtoj pyetjen.

Pyetja ime është kjo: ministri i Financave të Kosovës, Besim Beqaj ka thënë se fondi për zhvillim të veriut do të funksionohet dhe do të auditohet në pajtim të plotë me ligjet e Kosovës. Sipas informatave në shtyp ky fond aktualisht është funksionalizuar. Fondi për zhvillimin e veriut, përveç mbledhjes së të hyrave nga importi i mallrave, nga pikat

doganore në veri parasheh gjithashtu se mund të përfitojë grande nga Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë, si dhe donacione të tjera.

Pyetja është: çfarë masash të veçanta keni marrë ju si Ministri e Financave për të kontrolluar këto para për shkak të rrezikut të lartë të keqpërdorimeve që ekzistojnë në veri? A keni ju akses të përditshëm në këto para dhe çfarë raporti kanë me Bankën Qendrore të Kosovës?

E kam shtruar këtë pyetje zoti kryetar, për një arsye të thjeshtë se pse Serbia gjatë 14 vjetëve të fundit ka ndarë 2.8 miliardë euro pikërisht për veriun dhe ka raportime të faktuara që këto para kanë përfunduar në xhepat e dikujt, pra janë vjedhur. Ka raportime serioze në lidhje me këtë dhe veriu vazhdon të jetë “gropa e zezë” ku si duket do të zhytet edhe ky fond.

Dhe, unë po ju them që po përgatiten vjedhje masive edhe me paratë që do të duhej të ishin pjesë e buxhetit të Kosovës dhe jo e këtij fondi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Ferid Agani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Për shkak që ministri sërish ka dezertuar prej seancës e lëmë që pyetjet t’i bëjmë në seancën e radhës, do t’i përsëris pyetjet edhe njëherë.

KRYETARI: I ke dy pyetje deputetë....

BEKIM HAXHIU: Dy pyetjet i lë për seancën e radhës.

KRYETARI: Mirë. Deputeti Glauk Konjufca pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Glauku s’është këtu, për ata tjerët po dihet. Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete do ta bësh pyetjen? Deputeti Shaip Muja, pyetje për ministrin Ferid Agani. Shaip, do ta bësh pyetjen?

SHAIP MUJA: Unë edhe pse nuk është ministri do të mundohem që t’ia adresoj sepse ekziston sekretaria e tij dhe ky është një mesazh edhe publik edhe institucional.

Unë jam duke ngritur një problem, të cilin e kam parë nga mediet duke u prangosur dhe më vonë duke u burgosur në mënyrë shumë të turpshme doktor Shpend Elezi dhe më intereson ta di, a kanë qenë të shteruara të gjitha procedurat profesionale, para se të burgoset ky doktor, i cili për mendimin tim dhe shumë të tjerëve, është ndër kardiologët më të mirë sot në Kosovë.

Cili ka qenë roli i Odës së Mjekëve në këtë drejtim dhe a ka qenë Oda e Mjekëve e njoftuar për rastin në fjalë? Çfarë mesazhi dëshiron Policia dhe Prokuroria, të dërgojë në opinion me mënyrat spektakulare të arrestimeve të tilla të profesionistëve shëndetësorë?

Shtrohet pyetja: A ka mundur prokurori të njëjtin ta ftojë në bisedë dhe nëse është e nevojshme edhe ta arrestojë, por jo në atë mënyrë dhe, nëse i njëjti del i pafajshëm, kush do të mund ta përmirësojë imazhin personal, familjar dhe profesional të tij në shoqëri, që unë mendoj kurrë?

Me këto veprime, mendoj se dikush me qëllim do ta rrënojë shëndetësinë e Republikës së Kosovës, edhe ashtu në gjendje shumë të vështirë. Shtrohet pyetja, kush janë ekspertët për vlerësimin e këtij rasti, nga aspekti i mjekësisë ligjore dhe kardiologjisë? Cilat janë statistikat e incidencës së vdekjes gjatë procedurave të kardiologjisë invazive, kur dihet se në klinikat më të njohura botërore incidenca është mbi 1%, apo duhet që për çdo vdekje të dyshohet mjeku dhe të veprohet në këtë mënyrë?

Ne në Kuvend, këtu kemi miratuar ligjin para ca muajsh të Odës së profesionistëve mjekësorë. Mendoj që është shkelur ligji nga ana e Prokurorisë së shtetit në nenin 3, për çka duhet të japë dikush përgjegjësi, në nenin 9, në nenin 23, në nenin 24 dhe 25, ndërsa nga Oda e Mjekëve...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Unë mendoj që edhe pyetjen e ke shtruar gabimisht, se është dashur t'u adresohet ministrave të tjerë, ministrin të Rendit dhe ministrin të Drejtësisë. Deputeti Xhafer Tahiri, pyetje për ministrin Ferid Agani.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja ime ka të bëjë pikërisht me ata pacientë të cilëve u duhet trajtimi nga logopedi dhe të cilëve po u mungon ky trajtim në QKUK, të cilin e shtroi kolegja Rita Hajzeraj, prandaj është e njëjta pyetje, dhe besoj se do të marrë një përgjigje me shkrim nga ministri dhe me kaq do të mbyllet kjo çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, jo shikoni, këtu në mënyrë elektronike, unë nuk jap komandë kur ta ndalë fjalën. Ata e dinë, regjia e di kur duhet ndalur fjalën a është harxhuar koha. Unë nuk menaxhoj me kohën, këtë ta dini. Unë kur them: "ndalja fjalën", veç atëherë unë kam komanduar, përndryshe tjetërkush e ka komandën në dorë sa i përket matjes së kohës.

Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

NAZANE BRECA: I nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse ministri Enver Hoxhaj nuk është këtu, unë do ta parashtroj pyetjen e besoj që në seancat e ardhshme do ta marr edhe përgjigjen.

Njohja e shtetësisë së Kosovës nga të tjerët është shumë e rëndësishme për ne, për arsye se do të hapen rrugët për zhvillimet në të gjitha sferat e kjo do të ndikojë në integrimin e Kosovës edhe në organizatat e ndryshme ndërkombëtare.

Pyetja ime është: Pse Kosova nuk aplikon për pranim në organizata ndërkombëtare, edhe pse në disa prej tyre i plotëson kushtet për anëtarësim?

Konkretisht pyetjen e kam: Pse Kosova nuk aplikon për anëtarësim në Organizatën Botërore të Shëndetësisë, ku kemi 106 njohje dhe nuk ka nevojë për ndonjë lobim specifik për t'u pranuar Kosova në Organizatën Botërore të Shëndetësisë, kur dihet se pranimi i Kosovës në Organizata Botërore të Shëndetësisë, do t'i rregullonte shumë çështje që kanë të bëjnë me sferën e shëndetësisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Në javën tjetër, mirë Albana!

Dhe, pyetja e fundit, deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Ferid Agani.

FATON TOPALLI: I nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Kohëve të fundit, mediet në Kosovë kanë raportuar për shtim të numrit të qytetarëve të infektuar me virusin AH1N1, të njohur me emrin “gripi i derrave”. Nga fillimi i vitit dihet për së paku 40 qytetarë kanë qenë viktimë të këtij virusi, deri tash është raportuar për së paku tri viktimë.

Gripi i derrave është përhapur edhe në Evropën Perëndimore, por edhe në rajon, si në Maqedoni, Shqipëri e Greqi. Në Kosovë ka pasur raste të regjistruara në Prishtinë, Viti, Pejë, Deçan, Dragash dhe komuna të tjera. Përhapja e gjerë gjeografike e gripit të derrave lë për të dyshuar se numri i rasteve është shumë më i madh se ai që është regjistruar.

Dihet se pasojat e gripit për një numër të caktuar personash me imunitet të dobët, mund të jetë fatale.

Pyetja parlamentare: Çfarë masash ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë për parandalimin e përhapjes së gripit të derrave dhe mbrojtjen e popullsisë nga ky virus?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht kërkoj falje për vonesën, për shkaqe objektive të agjendës që e kisha, përkundër përpjekjes që të jem me kohë. Ju qëndroj në dispozicion t'iu përgjigjem në të gjitha pyetjet që janë bërë paraprakisht, në qoftë se ka interes.

Përgjigje konkrete në pyetjen e deputetit Topalli. Institucioni relevant referent në Republikën e Kosovës për përcjelljen e situatës epidemiologjike, mbikëqyrjen permanente të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë është Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike. Ky Institut përcjell me vëmendje ecurinë e shfaqjes eventuale të gripit në Kosovë dhe këtë e ka bërë përmes gjashtë instituteve rajonale, situatën e sëmundjeve

ngjitëse në sezonin e dimrit, me vëmendje të posaçme në gripin AH1N1, bazuar në planin e veprimit, të cilin ky Institut e ka për këtë qëllim.

Sistemi ynë i mbikëqyrjes intensive gjatë muajve janar - mars të vitit 2014 ka grumbulluar dhe analizuar të gjitha rastet e dyshimit në influencë të të gjitha komunat e Kosovës. Gjithsej kemi identifikuar 10 764 raste të dyshimit në influencë, prej të cilëve në Qendër Kombëtare të Gripit janë diagnostikuar 64 raste pozitive në virusin AH1N1. 93 raste pozitive në virusin e gripit A, ndërsa në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë raportuar deri sot 4 raste në përfundim fatal, si pasojë e sëmundjeve kronike, që kanë qenë për shkak të komplikimeve klinike, që i përmendët edhe parëz.

Masat konkrete të Ministrisë dhe Institutit, gjatë këtyre përgatitjeve të ballafaqimit, Instituti Kombëtar dhe Ministria e Shëndetësisë në shtator të vitit 2013 kanë lansuar planin e aksionit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë së gripit në Kosovë. Meqë nuk është e mundur të parashikohet se a do të shpërthejë apo kur mund të shpërthejë, pandemia e gripit, intervenimet e hershme do të ndihmonin në parandalimin e pasojave katastrofale, ose së paku të shtyjme përhapjen e virusit dhe shfaqjen e pandemisë të përmasave globale.

Kështu që Ministria e Shëndetësisë në këtë drejtim sivjet ka siguruar 95 mijë doza vaksinë kundër gripit sezonal, e cila është shpërndarë në të gjitha institucionet e mjekësisë familjare. Aktualisht, situata epidemiologjike është në përcjellje të vazhdueshme nga Instituti Kombëtar, ku aktualisht dje dhe sot, më 18 dhe 19 mars, pra bëhet fjalë për dy ditët e kaluara, po mbahet punëtori me gjithë profesionistët shëndetësorë në përf forcimin e kapaciteteve dhe të raportimit, duke krijuar dhe përf orcuar qendrat e specializuara për raportim, të ashtuquajturat “sentinel”, ndër të parët në rajon, që jemi të të njëjtit standard me shtetet e Bashkësisë Evropiane.

Me gjendjen aktuale klimatologjike që po mbretëron në Kosovë, mund të pritët në ditët në vijim, shfaqje e rasteve të gripit të formës së lehtë në raste sporadike dhe të rënda te personat me sëmundje kronike.

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Ke pyetje shtesë, deputet?

FATON TOPALLI: Po, faleminderit!

Në medie ka pasur, gjithashtu, njoftime se janë duke u përdorë barëra me afat të skaduar, sa i përket gripit të derrave, cili është qëndrimi juaj rreth këtyre informacioneve?

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI FERID AGANI: Po, faleminderit!

Vetëm desha ta them edhe vetëm një fjali, se edhe një organ që përcjell gjendjen epidemiologjike në mënyrë ditore, është Komiteti kombëtar i sëmundjeve ngjitëse, i cili në mënyrë të rregullt e përcjell këtë situatë.

Sa i përket pyetjes lidhur me barin tamiflu, i cili është një medikament, i cili përdoret në trajtimin e influencës me virusin AH1N1, Klinika Infektive e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka në dispozicion sasi të konsiderueshme të këtij bari dhe këto sasi kanë qenë të siguruara në vitet e kaluara, sepse siç jeni në dijeni, rastet e para me grip të derit në Kosovë janë lajmëruar në vitin 2009.

Ky ilaç dhe paketimet që i disponon Klinika e Sëmundjeve Ngjitëse e ka të shënuar afatin e skadimit në tetor të vitit 2013, por meqë me raste të tilla janë ballafaquar edhe vendet tjera në Evropë dhe më gjerë, qëndrimi i autoriteteve rregullative të barnave të Agjencisë Evropiane të Barnave EMA dhe Agjencisë Amerikane të Barnave FDA, ka qenë që shtetet të cilat kanë sasi të këtij produkti mund ta përdorin atë lirisht edhe dy vjet pas skadimit të afatit, pasi që produkti mund të përdoret 5-7 vjet prej datës së prodhimit.

Pavarësisht prej kësaj, ne jemi duke prokuruar, jemi në proces të prokurimit të sasive të reja të këtij preparati. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi kaluar ato pyetje. Pyetjet e deputetëve, që nuk morën përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45, pika 11 e Rregullores së Kuvendit.

Urdhëro, Ismet!

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Unë të falënderoj, po më lejo që në emër të disa deputetëve, që i kanë bërë pyetjet edhe të grupit parlamentar, singërisht për të shprehur shqetësimin tonë për mosgatishmërinë e ministrave që të përgjigjen në pyetje të deputetëve.

Unë po e them në emër të Grupit Parlamentar, sepse kjo ka disa herë që po ndodh, jo vetëm ndaj deputetëve, normalisht të LDK-së në këtë rast, po të gjithë deputetëve, dhe kjo injorancë, ky injorim që u bëhet gjithmonë me përjashtime, dhe jo që janë sot këtu, po këta janë, mund të thuhet, më të përgjegjshmit, për mendimin tim, prej ministrave, por nuk di a japin llogari këta ministra dikujt dhe ai kryeministër këtij Kuvendi, që do të duhej logjikisht të jetë këssoj?

Vërtet, ky injorim që u bëhet deputetëve, veçmas në pjesën e pyetjeve, është e papranueshme, sepse pyetjet i marrin shumë më herët dhe e dinë kur është seanca. Kjo tregon që absolutisht nuk janë në nivel të përgjegjësisë dhe të gatishmërisë t' u përgjigjen pyetjeve.

Sigurisht, që pas tre vjetësh që po kalon kjo qeveri është vonë këta për t' u vetëdijesuar dhe për t' u bërë të përgjegjshëm. Është shumë e qartë, unë jam i vetëdijshëm, po unë nuk

mund të kaloj sot këtë pikë të rendit të ditës, pa e shprehur këtë shqetësim tonin edhe si grup parlamentar, po sigurisht edhe të tjerët deputetë, që e thanë edhe më herët.

Dhe, vërtet është e papërgjegjshme dhe sigurisht, njerëzit që lodhen, dihet që u jepet pushim, si duket, janë shumë të interesuar për të pushuar, dhashë Zoti dhe besojmë që ka për t'iu dhënë pushim, pas këtyre zgjedhjeve më gjatë, rrinë në shtëpi dhe i shohin në televizor seancat pastaj. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë e kuptoj kolegun tim të nderuar, zotin Beqiri se ka dëshirë për të ardhur në pushtet. Vërtet na ka trenuar duke thënë se kryeministri po bën fushatë, po andej këndej, po këtu po shihet se zoti Beqiri e shfrytëzoi këtë rast për të bërë pak fushatë.

Unë e them me përgjegjësi se kryeministri dhe ministrat janë shumë vitalë, janë shumë të pushueshëm dhe janë shumë të përgatitur edhe për mandatin e ardhshëm qeverisës dhe kam bindjen e thellë se qytetarët do të jenë ata të cilët do t'i vlerësojnë punët e mira, që janë bërë për këtë vend, për përmirësimin e jetës të qytetarëve të vendit dhe ministrat dhe kryeministri vazhdimisht kanë qenë të gatshëm të përgjigjen në pyetje, por edhe kolegu dhe të tjerët edhe qytetarët, besoj se i arsyetojnë, sepse janë të angazhuar me agjendë shumë të ngjeshur dhe janë duke bërë punë konkrete. Dhe, ne duhet t'i përkrahim këta ministra e këtë qeverisje dhe do të vazhdojmë kështu edhe në mandatin e ardhshëm, zoti Beqiri. Faleminderit, për përkujdesjen!

KRYETARI: Jo, unë mendoj që po e mbyllim këtë çështje. Urdhëro! Kundër replikë një minutë, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti Grabovci, sinqerisht po të kishte qenë Kabineti, ne pas fjalës tënde do të ishim ngritur në këmbë për t'iu duartrokitur për "punën e jashtëzakonshme" që po e bëjnë. Vërtet është e pakuptueshme ajo se si reagoni. Dhe, nëse ju besojnë qytetarët edhe fjalëve tuaja, le t'ju besojnë, por qytetarët po shihet, se çdo ditë e më tepër po e shohin, se vërtet këtu të gjitha mund të bëhen nga kjo qeveri, veç punë jo.

Dhe, sigurisht këtë do ta dëshmojnë qytetarët dhe nuk je ti ai që u thurë elozhe. Unë bëra vërejtje konkrete se nuk po marrin pjesë në seancë dhe asgjë më tepër.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

A ka vërejtje në procesverbal? Unë kam bërë pyetje, a ka vërejtje në procesverbal? Nuk ka.

(Ndërhyrje: Ka vërejtje...!)

Kush ka? Fjalën jua jap vetëm nëse keni vërejtje në procesverbal, përndryshe ua ndali. Në procesverbal, nëse keni vërejtje ua jap fjalën, për tjetër, ua ndali fjalën, këtë ta dini paraprakisht. Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me procesverbalin e kam këtë vërejtje, për mënyrën se si shkruhen ose si shënohen, si të them, në këtë procesverbal, pyetjet parlamentare.

E kam parë disa herë që shënohet vetëm pyetja dhe pastaj jepet që ministri, filani e dha, iu përgjigj deputetes, ose nuk iu përgjigj.

Do të ishte mirë që dy-tri fjali ku përgjigjet të shkruhen aty, kur nuk përgjigjet, natyrisht se s'ka çka të shkruhet.

Domethënë, është e njëjta logjikë, siç bëhet pyetja, edhe përgjigjja.

KRYETARI: Jo, jo, procesverbali është diçka tjetër, fjala komplet është në transkript. Ne po e miratojmë procesverbalin. Faleminderit!

Transkripti është diçka tjetër, procesverbali është diçka tjetër. Fjala, edhe pyetja edhe përgjigja e ministrit në transkript janë. Shqip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar!

Unë po të kuptoj që edhe ti je shumë i ngarkuar kohëve të fundit, po ke qejf për t'i përshpejtuar seancat. Ministri ka mundësi ta përfundojë...

KRYETARI: Regjia, ia ndal fjalën.

(Ndërprerje nga regjia)

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesen e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeten Salihe Mustafa, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Deputete, e ke fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e ka shqyrtuar Projektligjin në mes dy leximeve - Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave dhe ka pasur shumë debate e punës, sidomos rreth harmonizimit të këtij projektligji me Projektligjin e

transplantimit të organeve, por megjithatë Komisioni ka votuar në mënyrë anonime dhe të gjitha amendamentet sa janë në këtë projektligj janë të Komisionit funksional, andaj ju ftoj që ta votoni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 50 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit Funksional.

Të pranishëm janë 74 deputetë.

I votojmë tash amendamentet:

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 41

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 42

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 43

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 45

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 47

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 48

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 49

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 50

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë tekstin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 76 deputetë.

Konstatohet se me 65 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 04/L-192 për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Pika e pestë e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar dhe ka vendosur ta sjellë për miratim. Kemi edhe amendamente nga Komisioni për Integritet Evropian.

Më lejoni të them që amendamenti 27 i Komisionit për Integritet Evropian nuk ka marrë përkrahjen e Komisionit për Zhvillim, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Më lejoni t'iu them argumenti për të cilin është sjell, është ai argument për çka mendojmë na pra përfshirja e një pjese të nenit 19 që ka të bëjë pikërisht me direktivën e BE-s është hequr nga Komisioni.

Ne si Komision kemi thënë që ai paragraf duhet të qëndrojë, është më mirë të qëndrojë dhe në ndërkohë kemi marrë vendim që ta marrim edhe një sqarim nga Agjencia e Aviacionit Civil në mënyrë që ta sqarojmë, meqenëse bëhet fjalë për përfshirjen e direktivave të BE-s.

Agjencia ka thënë se është mirë të jetë, mirëpo në sqarimin e tij thotë, sidoqoftë edhe nëse nuk përfshihet nuk do të prishte punë sepse legjislacioni për qiellin e vetëm evropian tanimë është në fuqi edhe në Republikën e Kosovës. Pra, nuk ka ndonjë... edhe po të pranohej, pra, e kemi marrë ndërkohë edhe një sqarim shtesë që është në natyrën më shumë profesionale dhe Agjencia ka kompetencë për t' i transmetuar, t' i përfshijë e po ashtu edhe t' i respektojë dhe t' i zbatojë edhe direktivat e BE-së.

Më lejoni edhe, zoti kryetar, meqenëse edhe nga kolegu i Komisionit që ka qenë pjesë e grupit punues zoti Ymeri, e mora edhe një informacion që na u ka përvjedhur një gabim që është më shumë në përkthim, është fjala te neni 24 te praktikët asimilues, ndoshta do të ishte meqenëse është përkthim, ky ligj kryesisht përfshin direktivat e BE-s edhe nga njëherë përvidhen edhe gabime në përkthim, ndoshta do të ishte më mirë të jetë përkthimi: “praktikët e veçanta” dhe kjo do të ishte krejt në rregull.

Nëse bën, nuk jemi asnjë kundër si komision që të jetë e të përmirësohen në përkthim.

Nuk e di tash si bëhet kjo, po... mirë, po e thashë në fillim. Faleminderit!

KRYETARI: Shikoni, këtë e dorëzoni pasi ta miratojmë ligjin, këtë vërejtje Komisioni e dorëzon dhe pastaj ky është një, si të them, standardizim i tekstit dhe mund të bëhet pa u marrë sot ne me të. Po, ju e njoftoni për çka është fjala, me shkrim.

Shkojmë pra në miratimin e amendamenteve:

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

74 deputetë janë të pranishëm.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8, është i Komisionit për Integritet Evropian, me përkrahjen e Komisionit Evropian.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14 i Komisionit për Integritet Evropian, me përkrahjen e Komisionit Funktional.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20 i Komisionit për Buxhet, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27 i Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahje të Komisionit funksional.

Këtë ta hedhim në votim, në votim elektronik. Pra, votojmë për amendamentin 27 i Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahjen e Komisionit funksional. Votojmë tash!

77 deputetë janë të pranishëm.

Konstatohet se me 19 vota për, 36 kundër dhe 9 abstenime, amendamenti 27 nuk kalon, i Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Amendamenti 28 është i Komisionit për Integritet Evropian, me përkrahjen e Komisionit funksional.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 62 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 04/L-250 për Agjencinë e shërbimeve të navigacionit ajror.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar dhe ka propozuar amendamente, të cilat ia rekomandon seancës që t'i aprovojë, ndërsa amendamentet të cilat janë pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL të mos përkrahen. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Është propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë me elektronikë. Votojmë tash!

Nuk kalon. 5 vota për, 52 kundër dhe 3 abstenime.

Nuk janë 61 vota, ju e dini që duhet votuar edhe një herë.

E votojmë amendamentin 2

Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Nuk kalon amendamenti. 13 vota për, 51 kundër dhe 5 abstenime.

Amendamenti 3

Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Pra, e votojmë me elektronikë amendamentin 3, propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Edhe ky amendament nuk kalon, 16 vota për, 45 kundër dhe 8 abstenime.

Amendamenti 4

Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Nuk kalon as amendamenti 4, i propozuar nga deputeti Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit Funksional, i cili ka marrë 14 vota për, 42 kundër dhe 9 abstenime.

Amendamenti 5

Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Nuk kalon, pasi 15 vota janë për, 41 kundër dhe 9 abstenime.

Amendamenti 6

Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Nuk kalon, pasi për të kanë votuar 13 vota për, 38 kundër dhe 9 abstenime.

Ju lutem, e përsëritim edhe një herë amendamentin 6.

Votojmë të gjithë, ka mjaft deputetë të pranishëm. Janë 80 deputetë. Votojmë tash! Nuk kalon, pasi për kanë votuar 16 vota për, 47 kundër dhe 11 abstenime.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Propozim i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

16 vota për, 50 kundër dhe 8 abstenime, prandaj nuk kalon amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Edhe amendamenti 10 është i deputetit Goran Marinković, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Mirë e ka, po e kryejmë, por Gorani është dashur ta kërkojë edhe ai vetë fjalën. Nënkryetari Sabri Hamiti e ka një sqarim. Urdhëro, Sabri!

SABRI HAMITI: Zoti kryetar!

Zotërinj deputetë kolegë,

Besoj se është e drejtë e atij që i ka paraqitur amendamentet t'i arsyetojë para Kuvendit, por unë si deputet po ndiej nevojë, sepse unë i kam parë ato amendamente, ato janë precizime gjuhësore në serbisht dhe janë të gjitha të arsyeshme. Kaq!

Pse Komisioni s'i ka përkrahur, a është problem i procedurave, unë nuk e di. Unë flas me tekstin që e kam pasur në shtëpi, që e kam marrë nga Kuvendi. Kështu që, meqë kaloi

qysh kaloi, është punë e tij heq apo nuk heq dorë, zotëria që i ka paraqitur, por meqë janë të natyrave të precizimit në variantin serbisht të ligjit, ai le të merret vesh bashkë me Komisionin dhe le të redaktohet saktësisht gjuhësisht. Ky është propozimi im. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo është dashur të thuhet në fillim. Arben, urdhëro!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Teksti është redaktuar, është përshtatur dhe nuk është vlerësuar e arsyeshme që të konsiderohet si amendament, sepse është përshtatje në gjuhën serbe - përkthim, dhe është i përkthyer dhe i rregulluar prej Administratës. Nuk është e nevojshme të trajtohet si amendament. Për atë edhe nuk i ka përkrahur Komisioni. S'ka ndonjë arsye tjetër.

KRYETARI: Arben, nëse po të kuptoj, nuk ka pasur nevojë të jetë amendament për faktin se këtë mund ta rregullojë Administrata.

ARBEN GASHI: Po, e ka rregulluar.

KRYETARI: A është rregullua? Atëherë mirë. Tash e miratojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 70 vota për, 3 kundër dhe 5 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 04/L-228 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Kolegë deputetë,
Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Safetja nuk është. Kush është në emër të komisionit. Komisioni Funksional, a ka mendim për të deklaruar në emër të komisionit? S'ka.

Pas paraqitjes së raportit nga Komisioni FunkSIONAL, që s'patë raport, të drejtën për diskutim e kanë edhe përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ose përfaqësuesit e Qeverisë, ose deputetët. A e do kush fjalën?

Në emër të cilit komision? Në emër të Komisionit për Integritet, e ka fjalën deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Integritet e ka shqyrtuar këtë ligj dhe ne i kemi dhënë këto rekomandime:

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-044 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës është pjesërisht në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar të Bashkimit Evropian.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, pjesërisht janë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Arsyetimi i raportit: Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 26.2.2014 e shqyrtoi projektligjin dhe sipas traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian, neni 26, tregu i brendshëm dhe neni 119 politikat ekonomike dhe monetare, si dhe akteve të tjera sekondare, nuk lejohet krijimi i politikave ekonomike që janë në kundërshtim me parimet e ekonomisë së hapur të tregut dhe të konkurrencës së lirë.

Po ashtu, në opinionin ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, të cilin e ka vlerësuar edhe Ministria e Integritetit Evropian, konstatohet se ky projektligj është pjesërisht në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Komisioni nuk ka rekomanduar amendamente, për arsye të dispozitave zbatuese të këtij projektligji për periudhën transitorë, që do të parashihet me Marrëveshjen e stabilizim asocimit.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albana Fetoshi e ka kërkuar fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Unë e kam kërkuar fjalën për ta arsyetuar amendamentin tim, është amendamenti i dytë, a ta arsyetoj tani apo kur të vijë radha? Në rregull.

KRYESUESI: Kur të mbërrijmë para amendamentit, e kërkon fjalën, pastaj bisedojmë.

Në këtë projektligj pra, janë të propozuara gjithsej 3 amendamente. Tash do të vazhdojmë me votimin e amendamenteve, sipas radhës që janë paraqitur nga raporti i Komisionit FunkSIONAL.

Ma jepni, sa janë këtu brenda në sallë? I kemi 76 deputetë. Amendamentet e propozuara, i pari që është i Komisionit FunkSIONAL, kundër s'po shoh, edhe abstenim nuk ka, kalon.

Amendamenti 2, propozim i deputetes Albana Fetoshi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Deputetja propozuese e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Unë me këtë amendament kam propozuar që me rastin e tenderimit t'u jepet përparësi prodhuesve vendorë. Pra, e kemi të qartë se prodhimet e huaja janë ato që e kanë vërshtuar tregun vendor këtu. Edhe në procesin e tenderimit janë prodhuesit vendorë ata që po dëmtohen më së shumti, për shkak se duke e pasur parasysh se janë të paktë, edhe në procesin e tenderimit, nëse nuk u japim përparësi atëherë janë prodhuesit vendorë ata që po ngulfaten nga prodhimet e huaja.

Dhe, me këtë ligj e kemi parë që nuk po rregullohet kjo çështje, për shkak se ligji, më saktë, është pak i mangët në këtë drejtim, sepse nuk e sqaron se në rast se dy kompani vendore marrin pjesë në tenderim, njëra me prodhime vendore dhe tjetra me prodhime të huaja, atëherë ligji nuk e precizon saktë, se cili në këtë rast do ta fitonte tenderin, ose cili do të kishte përparësi në rastin e tenderimit, prodhuesi vendor apo prodhuesi i huaj. Prandaj, duke e pasur parasysh se është shumë e nevojshme që të ndihmohen prodhuesit vendorë, kjo është minimumi që mund të bëjmë, atëherë i ftoj deputetët që ta përkrahin këtë amendament dhe të votojnë për përkrahjen e prodhuesit vendor në procesin e tenderimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Në sallë i kemi 81 deputetë. Kolegë deputetë edhe regjia bëhuni gati, do të votohet për propozimin e deputetes Albana Fetoshi, është amendamenti 2 që nuk ka përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Votimi është 30 jo, 27, po, abstenim 6, nuk kalon amendamenti.

Vazhdojmë me votimin e amendamentit numër 3.

Kundër s'ka, abstenim s'ka, kalon amendamenti numër 3.

Ju thërras që ta votojmë, kemi 82 deputetë në sallë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, me të gjitha amendamentet e votuara më parë, votojmë tash.

Projektligji është votuar me 67 vota për, 9 abstenime dhe 0 kundër.

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamente të propozuara.

E ftoj kryetarin ose përfaqësuesin tash po them nëse s'është kryetari i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Vataj nëse s'është këtu, por në emër të këtij komisioni, zonja Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për Institutin e Kosovës për Administratë Publike është amendamentuar në komision dhe ka gjithsej 21 amendamente. Kontesti kryesisht ka qenë, pra i deputetëve në nenin e parë dhe në këtë drejtim opinionet e të gjitha komisioneve funksionale janë opinione pozitive, nuk do t'i lexoj një nga një, mirëpo të gjitha amendamentet e propozuara në komision kanë kaluar unanimisht nga gjithë përfaqësuesit e subjekteve në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Izmaku!

Atëherë, bëhemi gati t'i votojmë amendamentet gjithsej 21.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Në sallë i kemi 79 deputetë. I ftoj deputetët, që ta votojmë këtë ligj me të gjitha amendamentimet. Votojmë tash!

Me 68 vota për, 6 abstenime, asnjë votë kundër, Kuvendi e miratoi Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj nënkryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeten Time Kadrijaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin dhe rekomandimet. Deputetja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të neneve 57, 58 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në disa mbledhje të mbajtura ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, të propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2014, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë raport me rekomandime.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri miratoi raportin përfundimtar për Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, persona të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre dhe fton Kuvendin, që ta miratojmë sot këtë projektligj.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë kemi 75 deputetë. Teutë, në lidhje me çka e ke fjalën? Teuta Haxhiu e do fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

E di, nënkryetar, që nuk është e shpeshtë për ta marrë fjalën në leximin e dytë, por megjithatë ka qenë praktikë e këtij Kuvendi dhe unë dua ta ngre një shqetësim.

Më vjen keq, që nuk është kryetari i Parlamentit këtu, po dua ta ngre një shqetësim të përfaqësuesve të familjeve të viktimave civile të luftës, të cilat në asnjë institucion nuk gjetën përkrahje.

Do të filloj nga presidentja, nga kryetari i Parlamentit, me të cilin jemi takuar dhe u ka premtuar që do të diskutojnë shumë amendamente, po flas me shifra të specifikuara, kanë biseduar me të gjithë anëtarët e Komisionit, me kryetarin e Komisionit, po dhe anëtarë të tjerë dhe asnjë përgjigje.

Mua më shqetëson fakti që nuk është gjetur edhe nga ky Kuvend as një hapësirë më e vogla për këto familje, të cilat jetojnë skajshmërisht me një shumë 135 euro, t'i mbajnë familjet e tyre, t'i edukojnë, t'i shkollojnë fëmijët, kjo është më shumë se diskriminuese.

Prandaj, më vjen keq që kryetari u ka premtuar vazhdimisht, që do të bëjë jo presion por thjesht do të mundohet që këto amendamente, disa, aty ku mund të ketë mundësi të përfshihen në këtë projektligj dhe për shqetësim, asnjë nga këto amendamente nuk janë përfshirë këtu. Pra, premtimet kanë qenë publike, ato u janë drejtuar disa herë me shkresa, po janë takuar edhe me Grupin e Grave Deputete dhe asgjë nuk është bërë në këtë drejtim.

Prandaj, më vjen keq edhe nga Kuvendi që nuk e ka kryer obligimin e tij si duhet.

KRYESUESI: Ne dëgjuam mendimin e zonjës deputete. Unë nuk dua të komentoj tash, kush ka premtuar, qysh ka premtuar, se edhe deputetët këtu bisedojnë shpesh gjerë e gjatë, e mbasandaj s'i bëjnë amendamente. Në teknikën e legjislacionit, çka s'bëhet amendament, është fjalë për ngushëllim dhe për publik.

Kështu që, po kalojmë prej... Edhe më mirë, që...

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: E nderuar deputete,

Është e vërtetë që unë i kam pritur ata dhe u kam thënë që Komisioni është ai që bën amendamentimin e ligjit dhe ju komunikoni me komisione, kërkon nga Komisioni, që kur të bën debat për këtë çështje edhe ju t'i shfaqni mendimet tuaja. Dhe, unë personalisht po të kishin, do të thotë, të ishin bërë amendamentet, unë si çdo deputet do ta kryeja detyrën time.

Kryetari i Kuvendit as nuk i bën amendamentet, as nuk i shqyrton. Prandaj, është mirë secili deputet ta dijë detyrën dhe përgjegjësinë e komisioneve. Komisionet janë ato që i bëjnë amendamentet. Përndryshe, edhe unë po them, dhe iu kam thënë edhe atyre, që edhe ajo kategori, si të gjitha kategoritë që kanë pësuar nga lufta, duhet ta ketë një jetë të dinjitetshme dhe duhet ta ketë përkujdesjen e shoqërisë dhe të institucioneve të shtetit.

Unë më shumë nuk mund të bëj edhe unë jam një deputet si të gjithë ju, por e drejtoj, e udhëheq seancën dhe përfaqësoj Kuvendin, por vendimmarrja është e seancës dhe puna është në komisionet parlamentare.

Fjalën e ka kërkuar dhe deputetja Rada Trajković.

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovani predsjedavajući,
Kolege poslanici,

Normalno da ja imam rezerve i ne podržavam sve ono što je u funkciji favorizacije takozvane Oslobođilačke Vojske Kosova ali želim da kažem da je za mene vrlo prihvatljivo ono što se odnosi na žene koje su silovane, nažalost, tokom rata.

Želim da kažem da jedna od najmoćnijih oružja rata jeste nažalost, taj čin silovanja žena i posle rata sve možemo da izgradimo, i srušene kuće, porušenu infrastrukturu, možemo mnogo stvari da uradimo, da saniramo ono što se desilo, ali posledice silovanja zaista su trajne kod svih onih žena koje su bile izložene takvom činu od neodgovornih ljudi.

I u tom kontekstu, želim da podržim izjavu predsednice države, gospođe Atifete Jahjaga, ali bih isto tako volela da te žene ili makar one koje su najhrabrije budu zajedno sa predsednicom predstavljene javnosti kao način, kao borba, da se to više nikada ne desi, ali i kao podrška, jer znamo koliko one trpe mentalno, psihički, fizički, u smislu šikaniranja unutar porodica, jer mi smo ipak Balkan, konzervativno društvo i imamo jedan zaista potpuno neodgovoran odnos prema ženama, koje nažalost su stradale ne svojom krivicom, nego prosto nemam načina da govorim jednim neodgovornim načinom ponašanja određenih, što bi kazali, velikih ratnika. Hvala vam!

KRYETARI: Vazhdojmë me votim, por jemi këtu edhe për një çështje. Realisht ligji ka ardhur - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtave të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

Pse kjo nuk është përfshirë në ligj, është çështje e Komisionit. Deputetja ka mund të bëjë edhe amendamente, po nëse vërtet nuk përfshihen në ligj, ndoshta është mirë të hiqet kjo pjesë dhe të bëhet një ligj, të formohet një komision dhe të bëhet një ligj i veçantë për këtë kategori. Kjo mendoj që mund të bëhet.

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni, edhe pse ju e dini s'është praktikë fort për të folur po...

HYDAJET HYSENI: S'është kryetar, po kur praktikohet për dikë, atëherë duhet të respektohet për tjerët, madje edhe dje, nëse i jepet fjala dikujt për të arsyetuar votën, duhet t'i jepet edhe tjetrit.

Por unë kisha pikërisht për këtë çështje, meqë ka një mospërputhje midis titullit dhe përmbajtjes, propozoj një amendament verbal, praktikohet kjo në praktikën parlamentare, te ne s'e kemi praktikuar, por është krejt në rregull, që të bëhet një dispozitë në të cilën do të thuhet: "çështja e viktimave civile rregullohet me akt të veçantë". Dhe kjo do ta rregullonte edhe harmoninë mes titullit dhe ligjit dhe do të rregullonte shqetësimin e qytetarëve dhe të deputetes.

Dhe, vërejtja e dytë që desha ta them po ashtu si një nën-amendament verbal, që është në nenin 1, mund të konsiderohet çështje e standardizimit gjuhësor, por është përtej kësaj sepse ka të bëjë edhe me zbatimin në praktikë, ndonjëherë me formulime gjuhësore ndikohet edhe në anën funksionale.

Sintagma "viktima të dhunës seksuale gjatë luftës", e cila e ka zëvendësuar formulimin e mëparshëm të paqëndrueshëm, megjithatë është e pasaktë. Gjatë luftës ndodh gjithçka, po ligji trajton ato që janë të luftës, prandaj edhe janë viktimat e luftës, krimet e luftës,

kështu që propozimi im është që besoj në mirëkuptim të komisionit dhe të deputetëve, që kjo formë të përdoret edhe kur janë krimet ose viktimat e dhunës seksuale të luftës, jo gjatë luftës. Faleminderit!

KRYETARI: Nejse, gjuhësisht ndoshta është edhe ndonjë nuancë, por për mua s'prish punë. Kush është kryetari i komisionit? Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Po shumë kemi diskutuar për këtë ligj dhe kemi pasur shumë kohë të amendamentohet për secilin nen dhe për secilin titull. Tash jemi në këtë kohë kur duhet të ndryshojmë edhe gjyqësorin. Për mua s'prish punë, qysh doni ju.

KRYETARI: Mendoj që po del një problem që ndoshta duhet të mendojmë ta zgjedhim më vonë ose ta gjejmë një mënyrë...

A shkojmë në lexim të tretë?

Ne po e kalojmë, por atëherë një kategori po mbetet e pa përfshirë. Atëherë duhet ta formojmë një grup dhe ta bëjmë një ligj të shkurtër vetëm për atë kategori.

Atëherë, po vazhdojmë:

Amendamenti 1, me jo “gjatë luftës” po “të luftës” po e bëjmë, a jeni dakord? Mirë. Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër s'ka...

(Ndërhyrje)

Sa janë kundër amendamentit? Atëherë, po shkojmë me votim dhe votojmë amendamentin 3.

Regjia, bëhu gati! Votojmë tash!

A keni vërejtje në amendamentin e tretë apo të dytin? Në të dytin.

Atëherë, po votojmë prapë.

81 deputetë janë prezentë dhe votojmë amendamentin 2 dhe votojmë tash.

Kalon, me 63 vota për, 9 kundër, asnjë abstenim.

Në amendamentin 3, a ka vërejtje?

Nuk ka, kundër s'ka, abstenim s'ka miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit Funksional.

A ka kundër? Ka... shkojmë me elektronikë.

(Ndërhyrje)

S'ka nevojë, Albulenë. Pra, me përkrahjen e Komisionit Funksional, votojmë tash amendamentin 8, me përkrahje është.

Me 63 vota për, 10 kundër, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 8, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Amendamenti 9

Kundër ka. Shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 55 vota për, 17 kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 9.

Tani e votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 69 vota për, 9 kundër, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin numër 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*